

MASKA

*Revista Elektronike
Radio e RII në gj. shqipe
Nr.1, tetor, viti 2016.*



Shqiptarët në vitet e fundit janë

përballur me praninë mysafirëve të paftuar në vendin e tyre. Mysafirët të cilët janë prezantuar për popullin shqiptar me emrin "Muxhahedin" dhe opozitarë të sistemit shtetëror të Republikës Islamike të Iranit.

Këto janë Muxhahedinët të cilët pas shumë vite emigrimi jashtë vendit të tyre, më në fund gjetën strehim në Shqipëri. Në anën e kundërt ndodhet Qeveria e Republikës Islamike të Iranit dhe mediat dhe organet përkatëse të saj që e quajnë këtë grup me emrin "Monafekin" dhe theksojnë se ky është një grup terrorist, prandaj vazhdimisht kanë paralajmëruar për rreziqet që mund të krijohen nga pjesëtarët e këtij grupi për vendin dhe popullin e Shqipërisë.

Është e natyrshme se mes konceptit "Muxhahedin" dhe "Monafekin" ka një dallim të madh dhe qytetarët shqiptarë me siguri nuk kanë mjetet e duhura për të gjetur përgjigjen e saktë për këtë pyetje serioze se "çfarë është e vërteta e kësaj çështje?"

Revista elektronike "Maska" fillon të publikohet në sferën e internetit me këtë qëllim që me kalimin e kohës duke u mbështetur në argumente dhe dëshmi historike, juridike, shoqërore etj., të shpjegojë natyrën, objektivat dhe veprimet e Organizatës Muxhahedine Khalk dhe duke ofruar mjetet e nevojshme për publikun shqiptar që të gjykojë më drejtë në lidhje me këtë çështje, do të paraqesë edhe argumentet përkatëse në lidhje me vërtetësinë e pretendimeve të saj.

Padyshim se njohja e natyrës së një grupi i cili është formuar dhe ka dalë në skenën politike në vitin 1965, me qëllim të luftës së armatosur kundër ish-regjimit mbretëror të mbretit Muhamed Reza Pahlavi në Iran dhe pastaj, tre vite pas fitores së Revolucionit Islamik të vitit 1979 në Iran i drejtoi armët e veta kundër këtij Revolucionit dhe u pozicionua përkrahë Sadam Huseinit, ish-diktatorit të Irakut, duke kryer krime të mëdha kundër popullit të Iranit dhe

të Irakut; është një punë e vështirë të cilën synon ta bëjë revista "Maska". Një grup i cili me perceptimet e gabuara ndaj Islamit, gradualisht arriti në marksizëm dhe përgjatë më shumë se 30 viteve të jetës organizative në kampet amerikane në Irak, me veprimet e tij terroriste vrau mbi 17000 qytetarë iranianë në mesin e tyre shkencëtarë, intelektualë dhe funksionarë shtetërorë të Republikës Islamike të Iranit.

Një grup i cili deri para pak vitesh ishte në listën e zezë dhe në listën e organizatave terroriste të Amerikës, mirëpo në mënyrë të papritur u hoq nga kjo listë dhe u krijuan rrethanat për transferimin dhe strehimin e anëtarëve të këtij grupi në territorin e Shqipërisë.

Elementët e ndërlikuar të jetës organizative dhe mungesa e informimit rreth ngjarjeve që kanë ndodhur në kampet në të cilat anëtarët e këtij grupi kanë jetuar dhe kanë marrë trajnime të ndryshme ushtarake dhe luftarake përgjatë më shumë se 30 viteve, kanë shtuar edhe më shumë vështirësitë për ta njohur këtë grup në mënyrë sa më të drejtë dhe reale. Mirëpo revista "Maska" synon të qartësojë një pjesë të këtyre paqartësive dhe të kësaj çështje të errët me gjuhën e historisë dhe me dëshmi dhe dokumente të ndryshme në mënyrë që të zbulohet një pjesë e kësaj maske që ka mbuluar fytyrën e Organizatës Muxhahedine Khalk.

Është e natyrshme që për shkak të gjerësisë së temës dhe për shkak të tematikave të shpërndara në fusha të ndryshme dhe gjithashtu për shkak të historisë së Iranit me zhvillime të ngjeshura në tre-katër dekadat e fundit, nuk ka mundësi që në këtë revistë të trajtohen dhe shqyrtohen të gjitha çështjet dhe zhvillimet e periudhës në fjalë, sepse edhe nëse merren për trajtim, ato ndoshta do të pengojnë trajtimin e temës kryesore të kësaj reviste. Prandaj synojmë të krijojmë një sferë të dyanshme në mënyrë që edhe publiku shqiptar të paraqesë çështjet e errëta që ka në lidhje me projektin e qeverisë amerikane dhe shqiptare për strehimin e pjesëtarëve të Organizatës Muxhahedine Khalk në territorin shqiptar.

Kryeredaktori i revistës Maska

Historia gjithmonë ka qenë e mbushur me veprime terroriste që kanë marrë jetën e mijëra njerëzve dhe kanë privuar pjesëtarët e shoqërisë njerëzore nga të drejtat dhe liritë themelore të tyre.

Shumë paqartësi historike dhe shoqërore e kanë rrethuar këtë fenomen pikëllues dhe në të shumtën e rasteve diskutimi në lidhje me këtë fenomen, merr një formë emocionale ose filozofike dhe nuk sjell ndonjë rezultat efikas dhe të dobishëm.

Një pjesë e kësaj qasje i përket ekzistencës së këtij fenomeni, për arsye se terrorizmi është

tonë në lidhje me atë fenomen, është kufizuar në vlerësime të ndryshme dhe nuk na ka lejuar neve që të kemi një njohje të vërtetë dhe të thellë rreth atij fenomeni.

Në fjalorin terminologjik "Britannica" në definicionin rreth terrorizmit thuhet: "Terrorizmi do të thotë përdorimi sistematik i frikësimit, tmerrit dhe dhunës së paparashikuar kundër shteteve, popujve ose kundër individëve për të arritur një qëllim politik".

Mirëpo, unë personalisht i qëndroj besnik përkufizimit të Nehru-it (Jawaharlal Nehru) që ka bërë në lidhje me terrorizmin, aty ku thotë: "Terrorizmi përfaqëson periudhën fëmijërore të motivit revolucionar, terrorizmi është atraktiviteti i punës së fshehur të shoqëruar me rrezikime që tërheq burrat dhe grat e rinj aventuristë. Terrorizmi është sikur tërheqja e tregimeve policore".

Mirëpo pavarësisht se a janë të mirë apo të këqij, duhet të dihet se tregime të tilla që nga kohërat e vjetra kanë patur lexuesit dhe simpatizuesit e vet, lexuesit të cilët më parë dhe më shumë se të gjithë të tjerët, janë bërë viktimë e terrorizmit. Pjesëtarët e sektit hebre "Sicari" i cili ka qenë shumë i organizuar në Palestinë, ishin zhytur në një lloj pasioni dhe vrulli që

buronte nga bindjet fetare dhe vdekjen e konsideronin të ëmbël, prandaj pjesëtarët e tij dalloheshin nga ky aspekt me njerëzit e tjerë.

Pjesëtarët e sektit TAG në Indi nuk përfillnin vdekjen dhe viktimat e tyre i mbytnin duke i ngulfatur me litar të mëndafshhtë dhe këtë veprim e kryenin vetëm për kënaqësinë e Hyjneshës Kali gjë që kishte një tërheqje vdekjeprurëse për ata. Flijuesit e grupit "Hashashian" në Iran e mirëprisnin vdekjen



një fenomen i dhunshëm dhe me patjetër gjykimi në lidhje me këtë fenomen deri në një masë të madhe është nën ndikimin e kësaj karakteristike.

Jashtë rrethit të ngjarjeve terroriste aty ku mund të përfitohet nga tmerrit dhe dhuna e terrorizmit, gjykimet gjithnjë janë shoqëruar me pasion dhe përkrahje, prandaj pikërisht për këtë arsye ndonjëherë në lidhje me një fenomen janë krijuar mendime të ndryshme. Në këtë mes, forca e mendimit dhe e gjyqimit

dhe kishin bindje të fortë në të ardhmen e artë.

Sergei Gadoviç Neçajev, autori i librit "Dispozitat Revolucionare" dhe mbledhësi i parë i ideve të dhunshme në periudhën moderne, njeriun revolucionar e përshkruan në këtë mënyrë: "Njeriu revolucionar, është ai që ka humbur gjithë çka, ai nuk ka interes personal dhe nuk ka punë të veçantë, ai është pa ndjenjë, nuk ka varësi personale, nuk ka pasuri, nuk ka pronësi, ai nuk ka as emër, çdo gjë në atë është tërhequr në një gjë dhe i mohon të tjerat çfarëdo që të jenë, ai është i tërhequr drejt një ideje dhe drejt një pasioni, REVOLUCIONIT!

gjitha këtyre meritave të ashtuquajtura "revolucionare", mund ta vërejmë tek grupi terrorist Muxhahedine Khalk që ishte në Irak dhe tani është transferuar në Shqipëri. Ky grup terrorist ka shumë perceptime të gabuara nga Revolucioni.

Kërkimi i vdekjes me anë të sulmeve kamikaze, shkatërrimi i çdo gjëje që ekziston dhe që nuk ekziston, atraktiviteti i dhunës dhe motivimi në bazë të manifestimeve sektariste, janë vetëm disa prej karakteristikave të brumosura në trupin e pjesëtarëve të këtij grupi terrorist në emër të veprimeve revolucionare.

Pranimi i vdekjes me krahë të hapur nga ana



Njeriu revolucionar në thellësinë e qenies së tij jo vetëm në fjalë, por edhe në veprim, ka këputur çfarëdo lidhje me rendin dhe sistemin e përgjithshëm dhe me botën e qytetëruar në të gjithë qenien e tij. Ai ka këputur lidhjen e tij edhe me çdo ligj, me çdo meritë dhe të mirë, me çdo kontratë shoqërore dhe me çdo rregull moral. Njeriu revolucionar është armik i përbetuar i të gjithë këtyre dhe nuk jeton në mesin e tyre, përveç me qëllim që të shkatërrojë çdo gjë që jep më shumë siguri". Në periudhën bashkëkohore, shembullin më të mirë të të

e tyre, nuk është sikur djegia e fluturës mbi qiri, por sikur vënia e zjarrit në një pallat të madh vetëm për shkak të një pecete. Me fjalë të tjera, ata konsiderojnë se të gjithë njerëzit e meritojnë vdekjen dhe asgjësimin dhe nuk e pranojnë të drejtën e jetës për asnjë njeri.

Kur programi të jetë kështu, atëherë çfarë brengje mund të ekzistojë për njerëzit që digjen në zjarrin e urrejtjes dhe dhunës së tyre?!

Vazhdon...

Kjo është një përmbledhje e shkurtër e historikut të krimeve dhe veprimeve të organizatës politike-ushtarake të quajtur Muxhahedin-e-Khalk që u themelua para katër dekadash dhe që gjatë tre dekadave pas fitores së Revolucionit islamik në Iran, njihet kryesisht si grupi terrorist Munafekin.

Në lidhje me këtë organizatë ekzistojnë kryesisht tre gjykime brenda dhe jashtë Iranit:

1. Shumica e intelektualëve dhe aktivistëve politikë brenda dhe jashtë Iranit theksojnë se ky grup ka karakter të dhunshëm, strategjia e tij bazohet në forcën e armatosur, kundërshton thellësisht lirinë e shprehjes dhe këtë grup e konsiderojnë si një nga faktorët kryesorë të prodhimit të ciklit “terrorizëm-dhunë” që ka krijuar pengesa themelore në rrugën e thellimit dhe zgjerimit të demokracisë dhe të kulturës së tolerancës dhe dialogut.

2. Shumica e shtresave të ndryshme të popullit duke e quajtur këtë organizatë Munafekin (hipokrit) dhe duke e vendosur emrin e kësaj organizate përkrah emrit të Sadamit, shpalljen e urrejtjes dhe distancimin nga ky grup e konsiderojnë si një nga detyrat fetare dhe revolucionare. Në bazë të shumë sondazheve të kryera në baza shkencore dhe në shtresa të ndryshme sociale, edhe brezi i tretë dhe të rinjtë që nuk janë përballur direkt me veprat e këtij grupi terrorist, janë të mendimit se Muxhahedin-e-Khalk është një organizatë e armatosur që për arritjen e qëllimeve të saj, ka derdhur gjakun e njerëzve të pafajshëm dhe është vënë në shërbim të ushtrisë agresore të regjimit të Sadam Husejnit.

3. Në hapësirën zyrtare dhe ndërkombëtare e në veçanti pas shpalljes së qëndrimit zyrtar të qeverisë amerikane në tetor 1994, si dhe qëndrimeve të ngjashme të disa vendeve evropiane dhe të BE, që e njohën këtë organizatë si një grup terrorist që u përkrah nga regjimi i Sadamit, shumë organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të ndikuara nga sukseset diplomatike dhe politike të RII dhe në koordinim me zgjerimin e luftës ndërkombëtare kundër terrorizmit, e kanë denoncuar dhe dënuar organizatën Muxhahedin-e-Khalk. Madje edhe shumica e grupeve opozitare të RII jashtë Iranit, këtë organizatë e kanë quajtur sekt terrorist me ideologji të dhunshme e të përgjakshme. Studimet më të fundit të mbështetura në fakte e dokumente si dhe në tekste dhe kujtime të mbetura brenda kësaj organizate gjatë katër dekadave të kaluara, vërtetojnë qartë se formimi i një grupi politik të bazuar në “dhunë”, “gjakderdhje”, “ekstremizëm ideologjik”, “aventurizëm” dhe “mbi shenjtërinë e organizatës”, nuk mund të ecë e të veprojë në rrugë të drejtë, sepse nga rrënjët e kalbura dalin vetëm fruta të hidhura dhe helmuese. Gjendja e kësaj organizate pas shpalljes zyrtare të ndryshimit të ideologjisë në marksizëm në vitin 1976 dhe deri në fitoren e Revolucionit islamik dhe fillimit të kryengritjes së armatosur kundër sistemit të RII që nga vitet 80, dalja e kësaj organizate nga Irani dhe vendosja e saj në vendet perëndimore dhe në Irak, ka shënuar një përfundim politik dhe ideologjik të debatueshëm e të çuditshëm, nga i cili në këtë shkrim mund të përmendet vetëm një pjesë e vogël e tyre.

Themelimi i organizatës dhe përpilimi i ideologjisë


Në vitin 1965, 12 vite nga grushti i shtetit i Gushtit 1953 dhe 2 vjet pas shtypjes së përgjakshme të revoltës së 5 Khordadit, tre ish anëtarë të Frontit të dytë kombëtar dhe të Lëvizjes së lirisë, vendosën të organizojnë rezistencën e armatosur kundër regjimit të Shahut. Mohamed Hanifnezhad (26 vjeç), inxhinier agronom, Said Mohsen (26 vjeç),

inxhinier i urbanistikës dhe Abdureza Nikbin Rudsari (23 vjeç), student i matematikës që la përgjysëm studimet universitare, ishin bërthama fillestare e grupit dhe një vit më vonë këtij grupi iu bashkangjiti edhe Ali Asgar Badi Zadgan (25 vjeç), inxhinier i kimisë. Këta persona megjithëse personalisht ishin fetarë dhe të ndjeshëm ndaj besimit dhe veprimeve fetare të tyre, nga aspekti politik dhe ideologjik ishin produkte të Frontit kombëtar dhe të Lëvizjes së lirisë. Inxhinier Bazargan më vonë pohoi vetë se organizata Muxhahedin-e-Khalk ishte pjellë e Lëvizjes së lirisë dhe se bazat mendore dhe mësimet fillestare të tyre ishin marrë nga diskutimet dhe librat e tij dhe nga Lëvizja e lirisë. Produkti i parë i programit studimor të këtij grupi ishte libri “Njohja”. Metoda dialektike marksiste me ndryshim emri si “principi i njohjes dinamike”, ishte pranuar si një princip shkencor. Boshtet kryesore të këtij libri ishin materializmi dialektik dhe materializmi historik. Ky libër u shkruajt nga Husein Ruhani. Broshura më e rëndësishme e shkollës politike me titull “C’është rezistenca”, ishte shkruajtur nga Abdureza Nikbin dhe në të përputheshin mësimet marksiste me mësimet fetare. Libri ‘Plotësimi’ me autor Ali Mihandust dhe libri ‘Rruga e profetëve’ me autor Hanifnezhad, ecte po në atë stil dhe ishte një kombinim i mësimave marksiste dhe atyre islame.

Zgjerimi i organizatës dhe përgatitja ushtarake

Në vitet 1966 deri në vitin 1968 grupi filloi të funksiononte si organizatë. Në mesin e vitit 1969, Abdureza Nikbin u largua nga organizata dhe emri i tij nuk u përmend më. Në dokumentet dhe burimet e kësaj organizate përmenden vetëm tre persona, Hanifnezhad, Said Mohsen dhe Badi Zadgan, si themeluesit e parë të kësaj organizate. Në organizatë u krijuan pesë grupe studimore dhe ndërlidhëse të quajtura “grupi ideologjik”, “grupi politik”, “grupi i punëtorëve”, “grupi i fshatarëve” dhe “grupi i klerikëve”. Grupi i klerikëve që u formua në vitin 1970, kishte përgjegjësinë e kontakteve me klerikët luftëtarë dhe të tërheqjes së tyre për bashkëpunim me organizatën. Qëllimi

ishte që kjo organizatë të shfrytëzonte ndikimin e klerikëve në shoqëri për realizimin e qëllimeve të saj, e në veçanti për të përfituar përkrahjen popullore si dhe përkrahjen financiare. Më vonë kjo organizatë për të fituar përkrahjen e Imam Khomeinit i cili ishte internuar në Naxhaf, dërgoi atje një përfaqësues të saj, por kjo përpjekje nuk pati rezultat për shkak të largëpamësisë së Imam Khomeinit. Deri në vitin 1970 asnjë femër nuk pranohej si anëtare e organizatës. Kryesisht Hanifnezhad, lideri kryesor dhe më me ndikim i organizatës, kundërshtonte martesën dhe e konsideronte atë si pengesë në rrugën e rezistencës. Por më vonë, kërret e organizatës “zbuluan” nevojën e pranisë së femrave e në veçanti rëndësinë e shfrytëzimit të veshjes së tyre. Fillimisht, Puran Bazargan, motra e Mansur Bazargan që punonte në një medrese vajzash, u anëtarësua në organizatë dhe pastaj u anëtarësua motra e Mohamed Hajati, si dhe motra e familjes Rezai. Sipas fjalëve të Bahman Bazargan, anëtar i komitetit qendror të organizatës, “kushdo që kishte motër që hynte në punë, e sillte”. Këto femra në bazë të urdhërit të organizatës, kryenin “martesë formale” me anëtarët meshkuj të organizatës.



Edhe Puran Bazargan u bë gruaja e Mohamed Hanifnezhad. Lejla Zomorudian

dhe Fatime Amini si dhe një grup tjetër i grave dhe vajzave u anëtarësuan në po këtë formë në organizatë. Shumica e këtyre grave



dhe vajzave më vonë u abuzuan në forma të ndryshme nga anëtarët e organizatës dhe si rezultat, ky proces denigrues dhe imoral shkatërroi një numër të madh familjesh që kryesisht ishin tradicionale dhe fetare. Fatet e Lejla Zomorudian, Fatime Fartuk Zade, Manizhe Ashraf Zade, Simin Salehi, Tahire Mirza Xhafer Alaf dhe shumë të tjerave, ishin kryesisht vetëvrasja apo denigrimi psikik e deri te bashkëpunimi me shërbimin sekret të Shahut dhe kjo ishte pasojë e pikëpamjes së shfrytëzimit të femrës si një mjet për arritjen e qëllimeve politike. Në dimensionin politik dhe ndërkombëtar, meqenëse

organizata, revolucionet socialiste në Rusi dhe në Kinë i konsideronte si revolucione të të përvuajturve e të të shtypurve, ndërsa Maon dhe Leninin i konsideronin si vazhdues të rrugës së

profetëve në epokën moderne, kjo organizatë filloi të krijojë lidhje me disa qeveri dhe parti marksiste. Edhe në dimensionin organizativ, organizata ndoqi parimin komunist të quajtur “centralizëm demokratik” dhe në bazë të



këtij principi të gjithë anëtarët e organizatës duhet t’u bindeshin pa asnjë kundërshtim direktivave dhe vijës së udhëheqjes së organizatës. Në vitin 1970, organizata për të krijuar potencial ushtarak për të filluar aksionet e armatosura, vendosi të krijojë lidhje me organizatën palestineze Fatah dhe të shfrytëzojë mundësitë e kësaj organizate për trajnimin e militantëve. Një delegacion i organizatës i përbërë nga Asgar Badi Zadgan, Turab Hakshenas, Masud Raxhavi dhe Lotfali Behpur, shkoi në Aman të Jordanisë ku u takuan me përfaqësuesit e lëvizjes Fatah, të cilët premtuan se do të trajnojnë anëtarët e organizatës dhe do t’u japin atyre armët dhe pajisjet e nevojshme ushtarake. Pas marrëveshjes me Fatahun, u dërgua grupi i parë i anëtarëve të organizatës nëpërmjet Dubait. Por pas një incidenti, policia e Dubait dyshoi te këta persona dhe i arrestoi dhe burgosi ata, si dhe u tregua e gatshme që këta persona t’ua dorëzonte autoriteteve iraniane. Por anëtarët e organizatës në Iran për shpëtimin e tyre, dërguan dy anëtarë në Dubai. Këta dy persona me mënyra të ndryshme arritën të hyjnë në avionin me të cilin po udhëtonin drejt Iranit anëtarët e arrestuar dhe duke shfrytëzuar armët dhe lëndë eksplozive, e rrëmbyen avionin dhe e ulën në Bagdad. Me ndërhyrjen e Fatahut, këta persona u dërguan në Jordani dhe atje filluan trajnimin ushtarak dhe mësuari

taktikat e luftës partizane. Pas transferimit të bazave nga Palestina në Liban, një numër më i madh i pjesëtarëve të organizatës u trajnuan në bazat palestineze në Liban. Disa anëtarë arritën që nëpërmjet Libanit të sjellin një sasi

armësh dhe municionesh në Iran. 22 persona u dërguan në bazat e Fatahut dhe shumica e tyre u rikthyen në Iran në vitin 1972.

Vazhdon...

Nuk është e padrejtë nëse thuhet se

Revolucioni Islamik i Iranit ka filluar në vitin 1978 dhe mori formën e tij në vitin 1981. Një vështrim i shkurt mbi ngjarjet e vitit 1981, do të bëjë të qartë rolin e këtij viti në formimin e Republikës Islamike. Ajetullah Imam Khomeini (ra) vitin 1981 e ka shpallur "Vit të mëshirës, vëllazërisë dhe sundimit të ligjit".

Kjo është bërë ndoshta për këtë arsye që mosmarrëveshjet mes forcave të ndryshme politike të zgjidhen në mënyrë vëllazërore dhe vendi të shkojë drejt unitetit, mirëpo ngjarjet dhe potenciali i forcave politike caktoi një fat tjetër për vendin e Iranit. Ky ishte një vit me plotë ngjarje.


Në sferën politike

Që nga fillimi i vitit 1981, mosmarrëveshjet mes forcave të linjës së Imam Khomeinit (ra) dhe të linjës së Beni Sadr, presidentit të Iranit në atë kohë, u zgjeruan në masë të madhe. Beni Sadr i cili me moton "Uniteti kombëtar, rindërtimi ekonomik, siguri dhe spiritualitet", fitoi shumicën e votave në zgjedhjet e para presidenciale në Iran, pasi erdhi në pushtet sfida e tij me ndjekësit e Imam Khomeinit (ra) për çdo ditë bëhej më e madhe dhe më serioze. Mitingjet, fjalimit e zjarra dhe spekulimet e tij, tensionuan në masë të madhe atmosferën në vend.

Beni Sadr në fjalimin e 8 shtatorit të vitit 1980, akuzoi partinë "Republika Islamike" për monopolizim të pushtetit politik dhe pastaj ndoqi rrugën e shtimit të tensioneve në nivele të larta të funksionarëve të sistemit shtetërorë në kushte kritike të luftës.

Kulmi i skandalit të tij për shkatërrimin e sistemit, mund të konsiderohet ngjarja e 4 marsit të vitit 1981, do të thotë fjalimi me rastin e përvjetorit të vdekjes së ish-kryeministrit iranian Mosadegh që u mbajt në Universitetin e Teheranit në sheshin Azadi. Grupi Muxhahedine Khalk i cili me këtë dekret bëri koalicion më të fortë politik me Beni Sadr, mori pjesë me gatishmëri të plotë në këtë tubim. Atmosfera kulturore e papërshtatshme dhe motot radikale dhe provokuese, krijuan rrethanat për një atmosferë të tensionuar dhe të dhunshme. Pas paraqitjes së motive radikale nga ana e përkrahësve të Beni Sadr ose pikërisht nga grupi Muxhahedine Khalk, ndiqej një politikë për shtimin e tensioneve në nivel të funksionarëve të lartë të shtetit dhe Beni Sadr në mënyrë të përsëritshme nga përkrahësit e

tij do të thotë nga garda mbiligjore e presidencës dhe nga pjesëtarët e Organizatës Muxhahedine Khalk të cilët ai i quante "popull", kërkonte që të kundërshtojnë në mënyrë serioze kundërshtarët e



Abul-Hasan Beni Sadr, presidenti i Iranit 1979-1981

tij të cilët në realitet ishin qytetarët ndjekës të Imam Khomeinit (ra).

Me shtimin e mosmarrëveshjeve të funksionarëve shtetërorë në mars-prill të vitit 1981, një delegacion u emërua nga Imam Khomeini (ra) për të shqyrtuar mosmarrëveshjet e krijuara ndërsa gazetat u

paralajmëruan që të mos publikojnë materiale të cilat shkaktojnë trazira. Mirëpo, fillimi i punës së këtij delegacioni nuk ushtroi kurrfarë ndikimi për të parandaluar zgjerimin e provokimeve dhe trazirave.

Imam Khomeini (ra) në fjalimin e tij më datë 29 prill të vitit 1981, iu drejtuar grupeve politike të armatosura dhe përveçse u dha ultimatum, deklaroi: "E mira e juaj dhe e mira e popullit tuaj dhe e mira e të gjithëve është kjo që të dorëzoni armët dhe të hiqni dorë nga këto veprimeve djallëzore dhe të ktheheni në gjirin e popullit". Pas këtij fjalimi, organizata Muxhahedine Khalk e cila konsideronte se fjalimi i Imam Khomeinit (ra) i është drejtuar asaj, dërgoi një letër në të cilën duke shpjeguar padrejtësitë që janë bërë ndaj kësaj organizate, kërkoi edhe një takim me Imam Khomeinin. Ky takim u refuzua nga ana e Ajetullah Khomeinit. Imam Khomeini këtë takim e kushtëzoi me kthimin e pasurive të plaçkitura nga prona publike dhe arka shtetërore dhe me dorëzimin e armëve, si dhe theksoi se organizata në fjalë ka kërcënuar sistemin shtetëror me kryengritje të armatosur. Pas kësaj, organizata Muxhahedine Khalk dërgoi një letër presidentit Beni Sadr dhe me një veprim politik, kërkoi garanci për dorëzimin e armëve, por edhe kjo kërkesë u përballë me kundërshtimin dhe mospranimin e Beni Sadr për tu dhënë garanci pjesëtarëve të kësaj organizate. Me këtë veprim, Beni Sadr në një farë mënyre haptazi morri qëndrim kundër

Imam Khomeinit dhe sa më shumë që ai u afrua me Organizatën Muxhahedine Khalk, përkrahësit e linjës së Imam Khomeinit (ra) morën qëndrime më të prera kundër Beni Sadr.

Marrëdhëniet mes Beni Sadr dhe organizatës Muxhahedine Khalk zgjeroheshin për çdo ditë e më tepër dhe bëheshin më të hapura, ndërkohë që edhe organizata në fjalë ekzistencën e saj e shihte në mbajtjen në pushtet të Beni Sadr, prandaj më datë 7 qershor 1981 deklaroi mbështetjen e saj të plotë dhe të unifikuar ndaj presidentit Beni Sadr.

Imam Khomeini pas ngjarjes së 4 marsit të vitit 1981, emëroi Ajetullah Musavi Ardebili, prokuror i përgjithshëm i vendit në atë kohë, që të hetojë shpejtë dhe në mënyrë të prerë këtë ngjarje. Pastaj, delegacioni gjyqësor përgatiti një raport dhe ia dorëzoi atë prokurorit të përgjithshëm të Iranit në të cilin ishin theksuar mbi 12 raste të kryerjes së veprave penale që ishin në nivel të krimeve.

Në fund, pas tre muajve, më datë 9 qershor të vitit 1981, pas konsultimit me funksionarët e lartë shtetëror si me Ajetullah Beheshti, Sejed Ahmed Khomeini, Ajetullah Hashemi Rafsanxhani, Imam Khomeini (ra) me anë të një dekreti të shkurt, e shkarkoi Abul-Hasan Beni Sadr nga posti i komandantit suprem të cilin e mbante si zëvendës i autoritetit më të lartë fetar "Vali-e Fakih".

Në këtë kohë, organizata Muxhahedine Khalk e cila ishte shndërruar në një përkrahës të gjithanshëm të presidentit Beni Sadr, me anë të një deklaratë ofendoi dhe akuzoi institucionet revolucionare dhe funksionarët e sistemit shtetëror kurse në të njëjtën kohë me anë të propagandës kërkoi nga populli që ta mbrojë jetën e presidentit të Iranit.

Vazhdon...



Abul-Hasan Beni Sadr dhe Masud Raxhavi

Viti 1981 ndoshta mund të konsiderohet një vit i veprimeve më të mëdha terroriste të Organizatës Muxhahedine Khalk në Iran e cila pas vrasjes së funksionarëve shtetërorë, zgjeroi veprimet e saj terroriste në rajone të ndryshme të Iranit.

Këto veprime terroriste janë kryer për të krijuar frikë dhe tmerr tek qytetarët iranianë. Veprimet terroriste verbale të Organizatës Muxhahedine Khalk në realitet manifestuan nivelin më të ulët të poshtërimit të kësaj organizate përballë Revolucionit të ri të Republikës Islamike të Iranit, për arsye se zhgënjimi i krerëve të kësaj organizate, i shtyu pjesëtarët e këtij grupi që të vrasin në mënyrën më të egër grat, fëmijët dhe civilët iranianë.

Në ditët e vitit 1981, qytetarët iranianë kanë përjetuar krime të tmerrshme të kryera nga pjesëtarët e Organizatës Muxhahedine Khalk, në kohën kur populli iranian në një front tjetër, përballej me një luftë të imponuar. Ky grup terrorist shënoi skena të tmerrshme në memorien e qytetarëve iranianë duke e zhytur në zi një popull të tërë.

Qyteti Shiraz ishte një prej qyteteve i cili në masë të madhe vëmendjen tërhoqi e Organizatës Muxhahedine Khalk dhe në këtë qytet janë kryer shumë sulme terroriste.

Një prej këtyre sulmeve terroriste që ndodhi në rrugën Agha Babakhani, shkaktoi vrasjen e një fëmije 5 vjeçar dhe plagosjen e disa fëmijëve të tjerë, për arsye se pjesëtarët e Organizatës Muxhahedine Khalk kësaj radhe kishin zgjedhur një vend për shpërthimin e bombës në të cilin ishin duke lozur fëmijët.

Martir Muhamed Hadi Firuzabadi kishte lindur më 22 qershor 1976 në Shiraz. Babai i tij ishte punëtor në një furrë ndërsa nëna e tij ishte amvise. Ai me pasion të madh sëbashku

me nënën e tij merrte pjesë në protestat kundër regjimit mbretëror Pahlavi para fitores

së Revolucionit Islamik. Muhamed Hadi kishte vetëm 5 vjet kur më 3 nëntor 1981, në kohën kur ishte duke lozur me shokët e tij, u martirizuar për shkak të shpërthimit të një bombe të vendosur nga pjesëtarët e Organizatës Muxhahedine Khalk në vendin ku loznin fëmijët.

Atë çfarë do të lexoni në vazhdim, është një intervistë me nënën e martir Muhamed Hadi Firuzabadi.

"Në nëntor të vitit 1981 që përkonte me ditët e muajit Muharram dhe sipas zakonisht të përvitshëm, në shtëpinë tonë ishte organizuar ceremonia e zimbajtjes. Më 3 nëntor të vitit 1981, shkuam në shtëpinë e babait për ceremoninë e zimbajtjes.

Shtëpia e jonë nuk ishte larg shtëpisë së babait tim. Një pjesë toke afër një shkolle në atë lagje ishte shndërruar në një vend ku loznin fëmijët. Pas ceremonisë së zimbajtjes, u ktheva në shtëpi, mirëpo Mahdiu gjashtë vjeçar dhe Muhamed Hadi pesë vjeçar, ishin duke luajtur me top në atë vend sëbashku me fëmijët e tjerë.

Nuk kaloi shumë kohë kur u dëgjua një zë i tmerrshëm dhe të gjithë banorët e lagjes dolën në rrugë. Një pluhur i bardh kishte kapluar të gjithë vendin ku ishin duke lozur fëmijët dhe nuk mund të shikonim asgjë. Pjesëtarët e Organizatës Muxhahedine Khalk kishin shpërthyer një bombë në vendin ku loznin fëmijët.

Kur situata u përmirësua pak, një prej fqinjëve më th mua: "Fëmija yt është duke u djegur".

Nuk e kuptoja gjendjen time. Njerëzit që ishin aty e ndaluan shpejt një taksì. Mahdiut iu kishte thyer këmba dhe kishte plagë shumë të rënda. Motra ime atë e vendosi në karrigen e pasme të makinës dhe unë mora n krahë

Muhamed Hadi dhe u ula në karrigen e parë të makinës. Fëmijët i dërguan në spital. Pastaj nuk më lejuan që ta shikoj Muhamed Hadi dhe vetëm më thanë se e kanë shtrirë në krevat. Të nesërmen e asaj dite më lajmëruan për vdekjen e Muhamed Hadi. Ai kishte vdekur menjëherë pasi arritëm në spital.

Pjesëtarët e Organizatës Muxhahedine Khalk nuk patën mëshirë as edhe për fëmijën tim pesë vjeçar.

Copat e bombës kishin goditur në kokë Muhamed Hadin. Njëri prej syve i kishte dalë nga vendi dhe ishte varur në fyturën e tij. Ishte një skenë shumë e tmerrshme të cilën kurrë nuk do ta harrojë.

Plagët e këmbëve të Mahdiut u bënë shkak që ai 20 ditë të qëndrojë i shtrirë në spital. Në

Para fitores së Revolucionit Islamik të Iranit, kisha zhvilluar disa aktivitete. Muhamed Hadi ishte 3 vjeç të cilin e merrja me vete në protesta. Pas fitores së Revolucionit Islamik të Iranit në kohën kur regjimi Ba'th i Irakut sulmoi Iranin dhe vendi u përballë me luftë të imponuar, e gjithë periudha e fëmijërisë së Muhamed Hadi duke përfshirë edhe lojërat e tij, ishte nën ndikimin e atyre ngjarjeve.

Më kujtohet kur një shkop e kishte bërë në formën e pushkës dhe me një litar që i kishte vënë atij shkopi, e vendoste atë mbi supet e tij dhe me jastëk ndërtonte bunker për vete, ndërsa mbathte çizmet e djalit të xhaxhait të tij dhe hynte në gjendje lufte.

Disa ditë para martirizimit të tij, unë e pash një ëndërr me Muhamed Hadi kisha shkuar në protesta dhe forcat e gardës mbretërore na ndiqnin neve.

Ikëm nga ata dhe u futëm në një shtëpi. Në atë qast spiritual, një i panjohur më mori

Muhamed Hadin nga dora dhe e dërgojë në një dhomë. Rreth e rrotull tavolinës e cila ndodhej në mes të dhomës ishin ulur shumë klerikë fetarë. Njëri prej tyre më tha mua: "Ky

fëmijë është i yni".

Shpresoj që Zoti t'i dënojë pjesëtarët e Organizatës Muxhahedine Khalk ashtu siç e meritojnë për shkak se kanë vrrarë njerëzit e pafajshëm dhe na kanë pikëlluar neve në këtë mënyrë".



këmbët e tij kishte shumë copëza nga shpërthimi i bombës. Kishte shumë dhimbje.

Mahdiu kishte lindur në natën e ditëlindjes së Imam Mahdi (axh.) dhe Muhamed Hadi disa vite më pas gjithashtu kishte lindur në ditëlindjes së Imam Mahdi (axh.).

Transferimi i 3 mijë muxhahedinëve

në Shqipëri mund të jetë një “tenxhere me presion” për sigurinë e këtij shteti dhe të gjithë Evropës.

Kështu e komenton portali “Huffington Post” marrëveshjen e qeverisë shqiptare me atë amerikane për të strehuar muxhahedinët iraniane, në një shkrim me titull: A mundet Shqipëria të përmbushë detyrimin e saj për të c’radikalizuar një prurje terroristësh në Europë?”. Në këtë shkrim, gazeta eidenton se ky grup i opozitës iraniane që prej viteve ’80 ishte kategorizuar nga CIA si një organizatë terroriste dhe pas 2003 ata kanë bashkëpunuar me ushtrinë amerikane në Lindjen e Mesme, për të luftuar terrorizmin atje.

Megjithëse në aparence duket se muxhahedinët po priten qetësisht, qytetarët shqiptarë kanë të gjithë të drejtën e zotit për të pyetur a përbëjnë këto refugjatë ndonjë kërcënim për jetët e tyre, sigurinë ne vend dhe ambicies për t’u anëtarësuar drejt Bashkimit European. Për t’iu përgjigjur kësaj pyetje ne duhet të pyesim se për çfarë motivi qeveria e Irakut është kaq e dëshpëruar për largimin e tyre dhe pse vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, e kanë refuzuar strehimin e tyre. Si një organizatë e dhunshme kriminale, muxhahedinët lulëzojnë aty ku sundimi i ligjit është i dobët, në vendi si Iraku dhe Shqipëria, ku ende

Gëzojnë probleme te së shkuarës. Në këto kushte muxhahedinët mund të jenë të rrezikshëm

përmes aktivitetit të tyre kriminal dhe të dhunshëm. Në këtë artikull eidentohet se pjesëtarët e grupit janë të trajnuar mirë dhe kanë financime të mëdha, çka i krijon terren që në kushtet e një vendi ku mungon sundimi i ligjit, ato të depërtojnë në grupet kriminale dhe të kenë mbështetje politike. Sikurse argumentojnë ekspertët, liderët e muxhahedinëve nuk e kanë problem krijimin e lidhjeve me zyrtarë të lartë të qeverisë, njerëz të pushtetshëm dhe media, pasi, të jemi të qartë, ata janë të mirëfinacuar. Në të shkuarën, ka patur vazhdimisht raportime ku liderët e MEK kanë patur lidhje me grupet mafioze në Shqipëri.

Ata do të punojnë me këtë grupe për benefite të përbashkëta sikurse bënë gjatë regjimit të Sadam Hyseinit. Duke e parë në procesin afatgjatë, nëse muxhahedinët krijojnë lidhjet politike, të cilat gjenerojnë përfitime dhe nga terrorizmi, mund te thuhet se ata operojnë me mire nga Tirana, sesa nga Parisi. Shkrimi i “Huffington Post” mbyllet me një citim te Kryqit te Kuq teksa thotë se “Si individë tre mijë muxhahedinët që do të strehohen në Shqipëri, nuk janë asgjë, por kur e shohim atë si grup, as ne dhe asnjë organizatë tjetër, nuk mund të ndihmojë në këtë çështje.

Kjo është një problem që qeveria shqiptare nuk mund të injorojë, sepse të bësh asgjë do të thotë të rrezikosh gjithçka”.



“Libri “ Fati im me Muxhahedin-e-Khalk”, njohja me grupin MEK

Libri “ Fati im me Muxhahedin-e-Khalk” është shkruar nga Parviz Derakhshan dhe është përmbledhje e anëtarësimit të tij për dy vjet e gjysmë në grupin MEK në kohën e Sadam Huseinit, i 4 viteve robërim nga forcat amerikane dhe qindra orë intervista dhe bashkëbisedime me anëtarët e grupit MEK. Ky libër është shkruar për të përshkruar një eksperiencë të hidhur në kuadër të një kulti fetaro-politik dhe për të përshkruar një pjesë të historisë bashkëkohore të Iranit.

Kapitulli i parë (Në rrjetën e organizatës)

Kapitulli i dytë (Nga gropa në pusin e burgut TIFP)

Kapitulli i tretë (Azili në perëndim)

Kapitulli i katërt (Kthimi në atdhe)

Në fund të librit ka pamje, foto dhe dokumente. Libri 500 faqesh “ Fati im me Muxhahedin-e-Khalk në vitet 2001-2008” është shkruar nga shtëpia e botimit të qendrës dokumentare Revolucioni Islamik. Më 3 tetor 2016 kemi arritur të bëjmë një intervistë me Parviz Derakhshanin, të cilën po e transmetojmë si më poshtë:

Ju lutem mund të na bëni një përshkrim të vetvetes dhe se si u anëtarësuat në kultin e Raxhavi?

Unë kam lindur në vitin 1968 në qytetin Ahvaz. Në vitin 1999 grupin Muxhahedin-e-Khalk e njihja vetëm si emër dhe kujtoja se ishte një organizatë që luftonte për liri dhe demokraci. Prandaj doja të bashkohesha me këtë organizatë. Radio Muxhahed, publikoi një numër telefoni nëpërmjet së cilës arrita të lidhesha me organizatën. Në atë kohë isha 32 vjeç dhe punoja si taksist. Për të shkuar në

Irak, veprova nëpërmjet Sirisë. Mirëpo qeveria siriane nuk më lejoi të kaloja në Irak dhe për këtë arsye u ktheva në Iran. Pas një farë kohe nëpërmjet një miku që kisha në Angli arrita të lidhem me organizatën. Ata më dërguan 1 mijë dollarë për të blerë një celular dhe për tu lidhur direkt me organizatën. Në atë kohë për shkak të operacioneve terroriste të grupit Muxhahedin-e-Khalk, agjencia e Iranit ishte tepër e ndjeshme ndaj lëvizjeve të mia. Unë shkova në Turqi, më pas në Dubai dhe nga Dubai në Irak. Për 2 javë kam qëndruar në dhomën e izolimit. Shumë të rinj ishin mbledhur aty me justifikimin e punës apo me shpresën për të shkuar në Evropë. Unë pasi dëgjova këtë gjë nisa të protestoja dhe thashë: Përse i keni sjellë në organizatë këta persona që nuk kanë asnjë prirje politike dhe rezistente? Pastaj shkova në zyrën e pranimit dhe për 9 muaj kam marrë trajnime politike, organizative dhe ushtarake. Më pas u ndamë në grupe. Unë së bashku me 20 veta të tjerë u përqendruam në bazën Habib në afërsi të qytetit Basra. Në bazën Habib qëndruam 3 muaj dhe pas nisjes së sulmeve të Amerikës,

سرگذشت من با مجاهدین خلق
۱۳۸۷-۱۳۸۰
پرویز درخشان

ne shkuam në kampin Ashraf. Unë kam qëndruar në organizatë për 2 vjet e gjysmë. Pas luftës mes Amerikës dhe Irakut, kur pamë se organizata nuk luftonte



për liri, nuk kisha më dëshirë të qëndroja dhe me dëshirën time dhe me shumë përpjekje u ndava nga organizata. Për një muaj kam biseduar shumë dhe kam thënë se ne jemi si “uji me vajin” dhe nuk përputhemi me njëri-tjetrin. Pasi shpalla ndarjen, mua dhe 2 veta të tjerë në pjesën e daljes na futën në burg për 45 ditë. Më pas na gjetën amerikanët gjatë kontrolleve të tyre. Amerikanëve u thamë që këtu jemi të burgosur. Amerikanët na dërguar në TIPF. Aty qëndruam 4 vite deri në vjeshtë të vitit 2007. Nëpërmjet OKB donim të shkonim në Evropë, por nuk ishte e mundur. Kur TIPF u mbyll, amerikanët na liruan.

Na dhanë dokumentet dhe na thamë të shkojmë ku të duam. Ne në fillim shkuam në Erbil, më pas ilegalisht u futëm në Turqi dhe pastaj shkuam në Greqi. Atje na thanë se me pasaporta false do të na dërgonin në Gjermani.

Gjatë rrugës në Zvicër na kapi policia gjermane. U përpoqa përsëri dhe u ktheva në Zvicër. Aty qëndrova për 2 muaj dhe më pas më kthyen në Gjermani. Në Gjermani për shkak se isha vetëm dhe për shkak të motit të ftohtë, mora vendim të kthehesha në Iran. Më 5 shkurt erdha në Iran. Ikja dhe kthimi im në Iran zgjati 8 vjet nga viti 2002 e deri në vitin 2010. Tani në Iran punoj dhe jetoj. Cili është qëllimi juaj me shkrimin e librit “Fati im me Muxhahedin-e-Khalk”

Unë kujtoja se të rinjtë iranianë nuk kanë informacion të mjaftueshëm mbi kultin Raxhavi. Përveç kësaj mendoja që njerëzit nuk e njohin mirë këtë organizatë. Për këtë e

pashë të nevojshme, që si një njeri që kam qenë pranë aktiviteteve të kultit, të qartësojë opinionin publik dhe shtresën e

të rinjve duke shkruar këtë libër. Në këtë mënyrë të rinjtë duke lexuar librin do të arrinin të kuptonin kultin Raxhavi, kult i cili përkundër pretendimeve për demokraci nuk është gjë tjetër veçse një kult që kërkon të arrijë pushtetin dhe jo lirinë. Me fjalë të tjera me këtë libër doja të tregoja karakterin real të kultit Raxhavi.

Si e analizoni largimin e kultit “Muxhahedin-e-Khalk” nga Iraku?

Largimi nga Iraku, për kultin Raxhavi ishte një disfatë e madhe. Ata thonin: Ashrafi është baza strategjike e jona dhe kurrë nuk duhet ta humbasim. Një prej thirrjeve të kultit ishte “Nëse nuk ekziston Ashrafi, trupi ynë nuk ekziston”. Humbja e Ashrafit, ishte fundi i ekzistencës së kultit dhe i sundimit i ideologjisë së tyre. Kultu Raxhavi për të qëndruar në kampin Ashraf deri në momentin e fundit ka dhënë të vrarë e të plagosur. Mirëpo më në fund ky kult u detyrua ta boshatisë kampin dhe të largohet prej aty pa asnjë dëshirë. Në vitin 2006 Masud Raxhavi (kreu i grupit MEK) ka thënë: “Ne duam të jemi afër atdheut, që të mund ta çlirojmë atë”. Tani që ndodhen në Shqipëri çfarë duan të bëjnë?

Për vite me radhë edhe pse kishin armë dhe bazë të caktuar ata nuk arritën të bëjnë gjë, ndërsa sot me pafytyrësinë më të madhe transferimin në Shqipëri e konsiderojnë fitore në një kohë kur nuk kanë armë. Kampi Ashraf ishte një vend ku mbi forcat kryeshin kontrolle dhe organizata mund të ruhej. Atje askush nuk kishte lidhje me

jashtë. Mirëpo në Shqipëri nuk është kështu, forcat kanë lidhje me jashtë.

Si e shikoni të ardhmen e organizatës Muxhahedin-e-Khalk (MEK)?

Nuk ka të ardhme. Për popullin iranian ata njihen si tradhtarë. Ata për vite kanë luftuar kundër Iranit duke qenë përkrah regjimit Bath të Sadam Huseinit. Përveç kësaj faktet e zbuluar nga anëtarët e ndarë të organizatës jashtë vendit, tregojnë se MEK nuk është një organizatë demokratike e cila mund të përcaktojë të ardhmen për Iranin. Unë që kam qëndruar për 2 vjet e gjysmë në këtë organizatë, me plot gojë mund të them se 70% e anëtarëve janë kundër organizatës, mirëpo qëndrojnë tek ajo për shkak të zhgënjimit, moshës së thyer dhe për shkak të varfërisë.

Ç ‘mendim keni për shpalljen e vdekjes së Masud Raxhavi?

Nëse Raxhavi ka vdekur unë do të gëzohem shumë. Takimi i fundit me Raxhavi është bërë vetëm 20 ditë përpara nisjes së luftës mes Amerikës dhe Irakut. Atëherë ai u shfaq në publik dhe mbajti një takim që nisi në orën 15 dhe përfundoi në orën 03 të ditës tjetër. Pas asaj dite nuk e kemi parë më Masud Raxhavinë. Ai nuk është paraqitur as në takimet e asamblesë publike dhe as në takime të tjera. Shpallja e vdekjes së Masud Raxhavi është një lajm i mirë për ata që janë ndarë dhe larguar nga organizata. Unë them se ka vdekur pasi kishte moshë të madhe. Raxhavi në një prej takimeve të tij thoshte: Mjekët më kanë vendosur shumë kufizime për shkak të sëmundjes. Ai prej një viti nuk ka nxjerrë asnjë mesazh zanor. Ka shumë mundësi të ketë vdekur. Mirëpo organizata për këtë çështje nuk ka mbajtur asnjë qëndrim dhe bashkëshortja e tij Raxhavi nuk ka reaguar aspak. Talebanët për 2 vjet e kanë mbajtur të fshehur vdekjen e Mula Omarit dhe vetëm pas 2 vitesh shpallën vdekjen e tij.

Si përshkruani mbështetjen e Arabisë Saudite për kultin Muxhahedin-e-Khalk

Arabia Saudite për shkak të kontradiktave që ka me Iranin, ka investuar në kultin MEK. Organizata MEK ka një karakter që gjithmonë kërkon padronë të rinj me qëllim që të zgjidhë problemet e saj financiare. Për këtë arsye është afruar me Arabinë Saudite. Mirëpo qeveria e Arabisë Saudite gabon pasi kulti Muxhahedin-e-Khalk është i njohur në Iran dhe tek populli iranian nuk zë asnjë pozitë dhe për popullin iranian kjo organizatë është një organizatë e urryer, terroriste dhe tradhtarë.

A mund të na sqaroni ngjashmërinë e lëvizjeve të organizatës MEK me ISIS gjatë viteve të fundit?

Organizata MEK në vrasjen e njerëzve, nuk është më vogël se sa ISIS. Në librin tim kam përmendur fjalët e njërës prej anëtarëve të organizatës që vetë ai ka qenë prezent në ngjarjen e vrasjes së 1 mijë kurdëve të Irakut brenda një nate. Organizata për të arritur fuqi (pushtet) ashtu si ISIS, nuk ka treguar mëshirë ndaj askujt dhe nëse e sheh të arsyeshme ajo nuk kursen as anëtarët e saj të cilët i burgos, i torturon dhe i vret.

Në fund të kujtimeve të Parviz Derakhshan në librin e tij, kujtime që janë transmetuar gjerësisht në internet, thuhet:

Sistemi ishte shumë agjenturor dhe i mbyllur. Çdokush ishte përgjegjës të kontrollonte dhe monitoronte një anëtar tjetër. Në rast se shihte apo dëgjonte ndonjë gjë, menjëherë duhej të raportonte me shkrim tek komandantët e lartë. Në rast se ai nuk raportonte, ndaj tij merreshin masa të rrepta. Me fjalë të tjera ishte krijuar një sistem i plotë spiunazhi i kopjuar nga sistemi në shoqërinë irakiane gjatë kohës së Sadam Huseinit. Në atë sistem një në çdo dy persona ishte spiun dhe bashkëpunonte me shërbimet agjenturore dhe ishte i detyruar të raportonte. Komandanti i sektorit të pranimit ishte një femër që quhej “ Motra Fereshte”. Vetëm pak pasi isha pranuar shkova ta takoja dhe bisedova me të për rreth 1 orë. Pothuajse gjatë gjithë kohë ajo përshkroi të kaluarën dhe kushtet e bazës Ashraf. Këto kushte ishin:

1- Formacioni i Muxhahedin-e-Khalk duhej të ishte si një gardë e hekurt. Ceremonitë programoheshin nga kryetari dhe të gjithë anëtarët duhej të dëgjonin në gatishmëri të plotë, me qëllim që të krijohej garda e hekurt. Duhet thënë se të gjitha vendimet jepeshin nga kryetari Masud Raxhavi.

2- Asnjë prej anëtarëve të Muxhahedin-e-Khalk nuk kishte të drejtë të posedonte pronë apo mjete personale. Në organizatë trashëgimia nuk ekzistonte dhe çdo gjë ishte e organizatës.



3- Çdo anëtar duhej të firmoste me gjak dhe frymë, d.m.th. me mish, shpirt dhe mendje të përkushtohesh dhe sakrifikohej për kryetarin, ndërsa për veten aspak.

4- Në ceremonitë e muxhahedinëve, falja e namazit dhe mbajtja e agjërimit ishte e detyrueshme

5- Një femër muxhahedine nuk mund të paraqitej në ceremoni pa mbajtur shami dhe hixhabi ishte i detyrueshëm për të gjitha femrat.

6- Ushqimi dhe veshja tek Muxhahedin-e-Khalk ishte falas, pasi në organizatë nuk kishte para dhe paga.

7- Në ceremoni nuk kishte muxhahedin mysliman jo shiit. Ata që nuk ishin myslimanë apo ata që ishin suni, ishin të detyruar të pranonin dhe konvertoheshin në shiitë. Në mesin e atyre personave që u detyruan të pranojnë këtë kusht ishte Eduardi dhe Filipi që me detyrim u konvertuan në

mysliman ndërsa Omar Mahmudi nga suni u kthye në shiit.

8- Të lexoje Kuranin gjatë ceremonive ishte e ndaluar dhe askush nuk kishte të drejtë të komentonte Kuranin, pasi kjo e drejtë i përkiste vetëm kryetarit.

9- Radio, televizioni, telefoni dhe interneti ishte e ndaluar.

10- Çdokush që arrestohej për shkak të lidhjeve seksuale duhej të qëndronte në burg për 2 vjet e gjysmë dhe pastaj për të do të merrej vendimi nëse do të qëndronte më apo jo në kamp.

11- Çdokush që mendonte të ndahej nga organizata, do të qëndronte në burg për 2 vjet me qëllim që informacionet që kishte të fshiheshin dhe më pas dënohej me 8 vjet burg në burgun Abu Gurejb për shkak se ishte futur ilegalisht në Irak. Pas 10 vitesh qeveri irakiane atë e dërgonte në Iran.

12- Askush deri në fund të jetës së tij nuk kishte të drejtë të martohej ose krijonte familje.

Këto ishin vetëm disa nga ligjet e MEK në kampin Ashraf. Në ditë për shikonim vetëm 90 minuta program televiziv, që kryesisht ishin këngë të organizatës. Në mëngjes, në drektë dhe në darkë kur hanim bukë. Telefon, radio, internet dhe gazeta nuk kishte. Çdo lajm që lidhej me jashtë kampit, transmetohej vetëm nga televizioni brenda në organizatë.

Lajmet që kryesisht ishin vetëm 15 minuta, jepeshin kur hanim bukë në drektë dhe në darkë. Lidhjet tona me botën jashtë, ishin të ndërprera plotësisht dhe ne nuk kishim të drejtë të krijonim lidhje as me njëri-tjetrin pasi kontrolloheshim rreptësisht nga organizata.

Pasditen e së hënës merreshim me pastrimin e jeshillëqeve, parimeve dhe me ndarjen e mishit, ndërsa pasditen e së premtes merreshim me pastrimin e kampit. Gjatë javës disa shkonin nëpër ara për mbledhur perimet që ishin mbjellë dhe t'i përdornin për përdorim të përditshëm. Disa të tjerë shkonin nëpër furrat e bukës, disa për të garantuar bulmetin dhe disa nëpër punishtet e ëmbëlsirave.

Parstoday është një sajt informativ iranian, i cili duke shfrytëzuar përvojën mbi 70 vjeçare të Shërbimit të Jashtëm të RTV të Iranit (IRIB Worldservice), ka filluar në një formë të re mediatike aktivitetin e tij në Janar 2016, duke transmetuar në mbi 30 gjuhë të botës lajme dhe informacione mbi zhvillimet kryesore në rajon dhe të botë.

Parstoday posedon shërbime mediatike si website, radio, transmetim përmes valëve në frekuenca, në internet dhe në celular si dhe në rrjetet sociale. Parstoday i transmeton informacionet për publikun në gjuhët shqip, arabisht, armene, bengale, kineze, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, husa, hebreje, indiane, indoneziane, italisht, japoneze, kazake, savahili, pashtun, portugalisht, rusisht, spanjisht dhe turqisht dhe numri i redaksive në gjuhë të huaja do të shtohet.

Zhvillimet politike në Lindjen e Mesme dhe roli i rëndësishëm i Iranit si një vend ndikues në rajon dhe si një vend i sigurt dhe në zhvillim, e shton edhe më shumë rëndësinë e Parstoday si një media me ndikim.

Parstoday në gjuhën shqipe ofron për publikun programe dhe emisione me tematika informative, politike, kulturore dhe fetare duke informuar opinionin me të pathënat e mediave botërore.

Programe të Parstoday në gjuhën shqipe ofrohen për miliona shqiptarë në rajonin e Ballkanit dhe në rajone të ndryshme të botës, të cilët janë të interesuar të njihen realisht me zhvillimet në Iran, në lindjen e Mesme dhe në vendet banuara nga popullsia shqiptare.

Për informacione të mëtejshme, kontaktoni me ne.

Parstoday.com/sq



albanian@parstoday.com

Tel: +98-21-22162833

Tel: +98-21-22162716

Celular: +98-903-5065501



facebook.com/ParsTodayAlbanian



instagram.com/parstodayalbanian



[@ParsTodaySq](https://twitter.com/ParsTodaySq)